



Data: 28.09.2020

Ref.: 1837/100

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KShC), në mbledhjen e 82-të, të mbajtur më 02.09.2020, mori:

V E N D I M

- I. Zgjatet periudha e akreditimit për programet e studimit të Universitetit të Pejës “Haxhi Zeka”, të cekura më poshtë për periudhën një vjeçare, 1 tetor 2020 – 30 shtator 2021:
 - Edukim në Muzikë, BA, 240 ECTS
- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

- I. Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC) në mbledhjen e mbajtur më 02.09.2020 ka marrë vendim për zgjatjen e periudhës së akreditimit të programeve të cekura në dispozitiv të këtij vendimi. Vendimi për zgjatje të akreditimit vlen vetëm për programet të cilat: 1. Kanë mbulueshmëri me staf akademik në harmoni me UA 15/2018, Neni 26, pika 5.3, sipas aprovimit nga KShC
2. Institucioni i Arsimit të Lartë ka dorëzuar aplikacionin për ri-akreditim dhe raportin e vetë-vlerësimit të programit të studimit, akreditimi i së cilit mbaron me 30 Shtator 2020;
3. Përkundër që IAL ka dorëzuar kërkesë formale për vlerësim të programit të studimit, AKA nuk ka arritur të organizoj vizitë vlerësuese me ekspert të jashtëm për programin në fjalë;
- II. KShC ka marrë këtë vendim bazuar në legjislacionin në fuqi. Sipas Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.04/L-037- datë: 29.08.2011, neni 15, Pika 3, “Riakreditimi i bartësve kryhet nga AKA-ja në intervale kohe prej jo më shumë se 5 vjetësh. Riakreditimi nuk bëhet pa një shqyrtim të raportit të vetëvlerësimit të bartësit, nga ana e ekspertëve, përveç në rrethana të veçanta. Vendimi për zgjatje të periudhës së akreditimit është marrë për shkak të rrethanave të veçanta dhe pandemisë së shkaktuar nga virusi Covid 19, e cila ka bllokuar punën normale të

institucioneve dhe gjithashtu ka paralizuar për një periudhë të caktuar edhe Aeroportin e Prishtinës, duke pamundësuar kështu ardhjen e ekspertëve ndërkombëtarë.

- III. Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC) në përputhje me legjislacionin në fuqi do të monitorojë në vazhdimësi Universitetin e Pejës "Haxhi Zeka" me qëllim që të sigurojë se kriteret minimale të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e IAL-ve në Kosovë (Nr.9/2017, datë 02.08.2017) plotësohen në vazhdimësi për paragrafin I të këtij vendimi. Në të kundërtën KShC i AKA-së rezervon të drejtën që në njërën nga mbledhjet e radhës të veprojë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi pasi të ketë konstatuar se ky institucion nuk ka arritur të sigurojë përmbushjen e kriterëve minimale të përcaktuara në këtë UA Nr.9/2017, datë 02.08.2017.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.


Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë



Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit të Pejës "Haxhi Zeka"
- MASH;
- Arkivit të AKA-së.